



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Korçë, më 22.12.2021

VENDIM

Nr. 22 datë 22/12/2021

“PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR”

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në nenin 5 të ligjit 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore”, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Kryesia, Këshilli i Qarkut Korçë,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shtesës të pensionit të posaçëm shtetëror:
 - Sotiraq Ilia Bratko, lindur në Korçë më 08.12.1951
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, zhvillimit ekonomik e shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TË QARKUT

ANA VERUSHI



Konceptoi: Gjergji Kristo
Sekretari i Këshillit të Qarkut: Bashkim Muço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

Për Përfitim të pensionit të posaçëm shtetëror

Për Z. Sotirraq Bratko

Në datën 20.12.2021, pranë Këshillit të Qarkut Korçë, është paraqitur kërkesa nga Qendra e Artit dhe Kulturës Korçë për të propozuar Këshillit të Ministrave caktimin e një shtese pensioni të posaçëm shtetëror mbi pensionin që i takon nga sigurimet shoqërore, z. Sotirraq Ilia Bratko.

Nga dokumentacioni që i ka bashkëlidhur kërkesës rrezulton se kërkuesi i përmbush kriteret ligjore të përcaktuara në VKM Nr. 429, Datë 12.9.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” që Këshilli i Qarkut Korçë ti propozojë Këshillit të Ministrave caktimin e një pensioni të posaçëm shtetëror.

I lindur në Korçë më 08.12.1951, z. Sotirraq Bratko e ka filluar karrierën e tij me aktivitete të ndryshme në grupin Teatër-Estradë të gjimnazit, për të vazhduar studimet në Institutin e Lartë të Arteve “Aleksandër Moisiu” në vitin 1970 dhe për tu emëruar pranë teatrit të Korçës nga viti 1973 e në vazhdim. Aktori Sotirraq Bratko ka një karriera gati pesëdhjetë vjeçare në fushën e aktrimit si në teatër dhe kinematografiduke me një kontribut të çmuar për vlerat e artit shqiptar. Gjatë karrierës së tij të gjatë ai është vlerësuar me një sërë titujsh, ndër të cilët mund të përmendim:

- Çertifikatë në Festivalin e tretë të filmit Shqiptar: Për interpretim në filmin artistik “Nujsa dhe Shtetprethimi”, Tiranë më 28.04.1979.
- Medalioni i Festivalit të 4-t të Filmit Artistik Shqiptar për interpretimin me nivel të mirë të rrit të punonjësit të sigurimit në film “Gëzhoja e vjetër”, Tiranë më 26.04.1981.
- Çmimin “Mirënjohje e thellë” për kontributin e dhënë në emigracion, nga (Klubi Drita, Lidnja e gruas së Greqisë së Veriut, Shoqata “Nënë Tereza”, Shoqata “Progresi”).
- Titullin “Emblema e Artë” nga Bashkia Korçë dhe Këshilli Bashkiak, “Për kontribut të veçantë në zhvillimin e artit dhe gjallërimin e jetës kulturore artistike korçare” datë 26.10.2010.

- Urdhërin “Naim Frashëri” i Artë nga Presidenti i Republikës, me Dekretin Nr. 6754 datë 09.11.2010.
- Aktori protagonist më i mirë i Edicionit të 13-të të Festivalit të Aktrimit “APOLLON 2014”.
- Çmimin “Qemal Ajdini” si Aktori më i mirë në Festivalin “Teatri Shqiptar në Maqedoni”- Dibër 2014.
- Çmimin special “Mirënjohje”, në Festivalin e Teatrove në Ferizaj 2015.
- Çmimi i Karrierës në Festivalin Ndërkombëtar të Komedisë-Korçë “KOKC FEST 2016”.
- Çmimi “KULT 2016” nga Akademia Kult, si Aktori i Vitit.

Z. Sotiraq Bratko i përmbush parashikimet e nenit 5 pika b të ligjit 7703 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Kërkesa përmban gjeneralitetet, e kërkesit dhe është e shoqëruar me dokumentat, si vijojnë:

- Fotokopjen e letërfitimit elektronik dhe certifikatën e gjendjes civile;
- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore për masën e pensionit;
- Kopjet e noterizuara të dokumentave që vërtetojnë meritat e veçanta si titujt, medaljet, urdhërat etj;

Dokumentacioni i paraqitur është konform VKM Nr.429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore”.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

ANA VERUSHI

Konc. Gj. Kristo


